

**AKTI I THEMELIMIT**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“AED FUTURE” SHPK**

Themeluesi i Vetëm i shoqërisë:

- **Gerian Kuka**, i biri i Reshat dhe i Suzana, i datëlindjes 23.03.1974, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shtetas shqiptarë, mbajtës i dokumentit identifikues letërnjoftim nr. 029080316 dhe numër personal H40323152I

sot më datë **12.02.2020** vendosi krijimin dhe themelimin e një shoqërie tregtare dhe për këtë qëllim harton dhe miraton këtë Akt themelimi, në përputhje me dispozitat ligjore të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe konkretisht me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, si më poshtë vijon:

**NENI 1**

***Emri***

Shoqëria tregtare mban emrin “AED FUTURE”.

Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

**NENI 2**

***Forma***

Shoqëria tregtare “AED FUTURE”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3**

***Zyra Qendrore***

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “AED FUTURE”, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Tiranë, Rruga “George W. Bush”, Nr. 25. Kulla 1, Kati 2.

**NENI 4**

***Objekti i Veprimtarisë***

4.1 Shoqëria ka për objekt veprimtaritë e mëposhtme:

- *Projektimin, ndërtimin, administrimin e centraleve që prodhojnë energji elektrike nga burime të rinovueshme nëpërmjet energjisë diellore dhe/ose asaj eolike/erës dhe/ose hidrike si dhe tregtimin e energjisë. Implementimi dhe menaxhimin e projektit gjenerues të energjisë elektrike nëpërmjet energjisë diellore dhe/ ose eolike dhe veprave ndihmese si dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i të gjitha lejeve dhe licencave të cilat mundësojnë*

*zhvillimin e këtij aktiviteti në mënyre të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë.*

*Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do ta ushtroje aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të lëshuara nga organet kompetente të fushës.*

*Shoqëria do të mundet të promovojë themelimin ose marrjen qoftë të drejtpërdrejtë, qoftë jo të drejtpërdrejtë, të pjesëmarrjeve në fitime, të kuotave ose të pjesëmarrjeve në ndërmarrje të tjera, shoqërive, konsorciumeve dhe enteve në përgjithësi, të gjitha këto në mënyrë instrumentale dhe në masë jo mbizotëruese kundrejt veprimtarive të tjera që përbëjnë objektin shoqëror.*

*Shoqëria do të mundë, gjithashtu, të kryejë të gjitha veprimtaritë e nevojshme ose të dobishme për përmbushjen e qëllimeve shoqërore, ndër të cilat operacione të paluajtshme, të luajtshme, industriale, tregtare dhe financiare, duke përfshirë këtu edhe dhënieve të garancive reale dhe / ose personale, të lëshuara në interesin e shoqërisë për obligacionet qoftë të vetat, qoftë të të tretëve. Të gjitha këto veprimtari duhet të zhvillohen brenda kufijve dhe duke respektuar normat që rregullojnë ushtrimin, si edhe duke respektuar legjislacionin në fushën e veprimtarive që u rezervohen të regjistruarve në Kolegje, Urdhra ose Regjistra profesionale, Në mënyrë të veçantë, veprimtaritë me natyrë financiare duhet të zhvillohen në përputhje me ligjet në fuqi në këtë fushë.*

#### **NENI 5** ***Kohëzgjatja***

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë “AED FUTURE” do të jetë me afat të pacaktuar.

#### **NENI 6** ***Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit***

Shoqëria tregtare “AED FUTURE” mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

#### **NENI 7** ***Përgjegjësia e Ortakut***

Ortakut nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë “AED FUTURE” dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tij.

#### **NENI 8** ***Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat***

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “AED FUTURE” SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

8.2 Ortaku i Vetëm i shoqërisë është zotëues i 1 (një) kuote me vlerë 100.000 (njëqind mijë) lekë e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

8.3 Kontributet që përbëjnë 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë janë shlyer tërësisht nga Ortaku i Vetëm z. Gerian Kuka.

**NENI 9**  
***Organet e shoqërisë***

Organet e shoqërisë "AED FUTURE" janë:

- Ortaku i Vetëm;
- Administratori.

Kompetencat, të drejtat dhe detyra e këtyre organeve do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

**NENI 10**  
***Dispozita të fundit***

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në Aktin e Themelimit dhe në Statut, do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

*Ky Akt Themelimi hartohet dhe firmoset në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.*

**THEMELUESI I VETËM**

**Gerian Kuka**

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Gerian Kuka', written over a large, faint, circular watermark or background mark.